


4080/15 26-09-2025



Në bazë të nenit 12 paragrafi 2 pika d) dhe nenit 49 të Ligjit për vetëqeverisjen lokale nr.03/L-040 ("Gazeta zyrtare e RK-së", nr.28/2008), nenit 13 paragrafi 1 të Statutit të Komunës së Graçanicës nr.6320/15 nga 22.10.2015, Kuvendi Komunal i Graçanicës në mbledhjen e tetë të rregullt, e mbajtur më datën 26.09.2025, merr këtë:

V E N D I M Nr.48/2025/KG

për miratimin e procesverbalit nga mbledhja e Kuvendit, e mbajtur më datën 29.08.2025

Neni 1


Miratohet procesverbali nga mbledhja e shtatë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 29.08.2025.

Neni 2

Pjesë përbërëse e këtij vendimi është procesverbali nga mbledhja e shtatë e rregullt e Kuvendit Komunal, e mbajtur më datën 29.08.2025.

Neni 3

Vendimi hyn në fuqi ditën e publikimit të vendimit në ueb-faqen zyrtare të komunës.

Kryesuesi i Kuvendit

Milan Dimitrijević




PROCESVERBALI

Nga mbledhja e shtatë e rregullt e Kuvendit të Komunës së Graçanicës

E mbajtur më datën 29.08.2025 në sallën e Kuvendit të Komunës së Graçanicës dhe filloi me punë në orën 11:00.

Kryesuesi i Kuvendit Komunal të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq, hapi mbledhjen duke i përshëndetur të gjithë të pranishmit dhe shtoi se në mbledhje nga 19 asamblistë janë të pranishëm 17 asamblistë dhe ka kuorum, ndërsa mungojnë 2 asamblistë: Ljubisha Karaxhiq dhe Granit Gashi. Në mbledhje morën pjesë edhe përfaqësuesit e KFOR-it, përfaqësuesi i OSBE-së, drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, të Planifikimit, Urbanizmit dhe Mbrojtjes së Mjedisit, Shërbimi për Informim dhe Shërbimi për Çështjet e Kuvendit.

Kryesuesi i njoftoi asamblistët se para mbledhjes së sotme të Kuvendit u mbajt mbledhja e shtatë e rregullt e Komitetit për Politikë dhe Financa dhe se komiteti njëzëri e ka dhënë mendimin pozitiv për rendin e ditës të propozuar.

Kryesuesi e hodhi në votim rendin e propozuar të ditës.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve “Pro”, miratoi rendin e mëposhtëm të ditës.

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 31.07.2025.
2. Informata për Qarkoren buxhetore 2026/02, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.
3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për formimin e grupit të punës për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2026, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.
4. Të ndryshme.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e parë të rendit të ditës:

1. Miratimi i procesverbalit nga mbledhja e parë e jashtëzakonshme, e mbajtur më datën 31.07.2025.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e parë të rendit të ditës.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e dytë të rendit të ditës:

2. Informata për Qarkoren buxhetore 2026/02, me propozim të drejtorit të Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, i paraqiti informatat për Qarkoren e dytë buxhetore 2026/2, duke shtuar se buxheti i Komunës së Graçanicës për vitin e ardhshëm, për shkak të regjistrimit të fundit të popullsisë, është më i lartë për 2.770.000 euro. Buxheti sipas kategorive ekonomike për vitin 2026 është si në vijim: për paga dhe mëditje 4,970,105.00€, mallra dhe shërbime 1,960,354.00€, shpenzime komunale 224,000.00€, subvencione dhe transfere 440,859.00€ dhe shpenzime kapitale 4,935,332.00€. “Një karakteristikë e Qarkores buxhetore është se na është dhënë mundësia për 24 vende të reja pune, nga të cilat 20 për kujdesin shëndetësor parësor dhe 4 për administratën komunale”.

Asamblistja Snezhana Jovanović, para partisë “SRPSKA”, pyeti nëse është përcaktuar lista e projekteve kapitale.

Drejtori i Drejtorisë së Buxhetit dhe Financave, Sllavisha Niçiq, u përgjigj se sipas ligjit ata duhet të paraqesin një propozim buxheti dhe një listë të projekteve kapitale për vitin 2026, si dhe parashikimet për vitet 2027 dhe 2028 deri më 31 gusht, ndërsa Kuvendi Komunal duhet ta miratojë atë deri më 30 shtator.

Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e tretë të rendit të ditës:

3. Shqyrtimi dhe miratimi i propozimit të Vendimit për formimin e grupit të punës për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2026, me propozim të kryesuesit të KK të Graçanicës, Millan Dimitrijeviq.

Kryesuesi e shpjegoi propozim-Vendimin për formimin e grupit të punës për hartimin e Planit të punës së Kuvendit të Komunës së Graçanicës për vitin 2026, duke shtuar se është zvogëluar numri i anëtarëve në 5 në krahasim me vitin e kaluar dhe janë propozuar asamblistët e mëposhtëm:

1. Millan Dimitrijeviq, kryesues i Kuvendit të Komunës së Graçanicës,
2. Ljubisha Karaxhiq, asamblist i Kuvendit të komunës;
3. Nebojsha Marković, asamblist i Kuvendit të komunës;
4. Sllagjana Rashiq, asambliste e Kuvendit të komunës;
5. Millosh Dimiq, asamblist i Kuvendit të komunës;

Meqenëse nuk kishte propozime të tjera, kryesuesi e hodhi në votim propozim-Vendimin për formimin e grupit të punës për hartimin e Planit të punës së Kuvendit Komunal të Graçanicës për vitin 2026.

Pas votimit, kryesuesi konstatoi se Kuvendi njëzëri, me votat e 17 asamblistëve “Pro”, miratoi pikën e tretë të rendit të ditës.


Kryesuesi i Kuvendit hapi diskutimin për pikën e katërt të rendit të ditës:

4. Të ndryshme.


Pasi që askush nuk e mori fjalën për të diskutuar lidhur me pikën “Të ndryshme” të rendit të ditës, kryesuesi falënderoi për bashkëpunim dhe mbledhja mbaroi në orën 11:08.

Procesmbajtësi:

Agron Karadollami



Kryesuesi i Kuvendit Komunal



Milan Dimitrijević

